



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Mbledhje e Komisionit të Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

Data 24.01.2025

RELACION

Komisioni u mbledh në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Njësia Administrative Bushat dhe shqyrtoi projekt vendimin e mëposhtëm:

Projekt vendim për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025.

Komisioni diskutoi projekt vendimin e paraqitur nga sektori i fuqizimit ekonomik pranë Bashkisë Vau Dejes. Ai u njoh me Kriteret Specifike të vitit 2025 mbi të cilat do të bazohet VKB për të trajtuar me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të kushtezuar për bllok ndihmën ekonomike familjet të cilat nuk shpallen fitues sipas formulës së pikezimit.

1. Familje të varfëra pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme, që nuk plotësojnë nevojat buzë për jetesë.
2. Familje që kanë në përberje një ose më shumë anetare me aftësi të kufizuar/invalid pune.
3. Familje me shumë femije
4. Familje me k/familjare femra pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme, dhe me probleme sociale.
5. Persona që jetojnë të vetëm, të moshuar, që kanë dhe probleme shëndetësore
6. Familje me të ardhura të pamjaftueshme që kanë në përberje femijë që ndjekin arsimin e lartë,
7. Familjet që nuk kanë banesë ose jetojnë me qera.
8. Familje që kanë në përbërje të moshuar, që nuk kanë pension ose e kanë pension minimal.
9. Kryefamiljare gra të veja apo të divorcuara pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme

Komisioni vlerëson se është zbatuar me korrektesë baza ligjore për hartimin e projekt vendimit dhe propozon që ky projekt vendim të miratohet në mbledhjen e muajit Janar 2025.

Kryetar
Albina Livadhi

Zv/Kryetar
Meliha Zyberaj

Sekretare
Sanije Salja



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Mbledhje e Komisionit të Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

Data 24.01.2025

RELACION

Komisioni u mbledh në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Njesia Administrative Bushat dhe shqyrtoi projekt vendimin e mëposhtëm:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetor 2024

Komisioni diskutoi projekt vendimin e paraqitur nga sektori i fuqizimit ekonomik pranë Bashkisë Vau Dejes. Ai u njoh me projekt vendimin e paraqitur për dhenien e ndihmes financiare, bazuar në fondet e kushtëzuara për muajin Dhjetor 2024, të përfitojnë 136 familje, me 472.767 lekë, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Dhjetor 2024 janë shpallur fitues, 1.015 familje, me fond 7.883.061 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 472.983 lekë. Komisioni shpreh dakortësi që përfitues nga ky fond të jenë familjet e paraqitura në projekt vendim.

Komisioni vlerëson se është zbatuar me korrektesë baza ligjore për hartimin e projekt vendimit dhe propozon që ky projekt vendim të miratohet në mbledhjen e muajit Janar 2025.

Kryetar
Albina Livadhi

Zv/Kryetar
Meliha Zyberaj

Sekretarë
Sanije Salja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Mbledhje e komisionit të financave, buxhetit, pasurive Bashkiake dhe planifikimit të zhvillimit strategjik të Bashkisë, mbikqyrjes financiare.

Data 24.01.2025

RELACION

Komisioni mori në shqyrtim projekt vendimin e meposhtëm:

Projekt vendim për rishikim të Vkb nr.87 datë 23.12.2024 për shtyrjen e afatit të Vkb Vau Dejës nr.71 datë 26.11.2020 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021" i ndryshuar me VKB nr.64 datë 26.11.2021, lënë në fuqi me VKB nr.78 datë 30.11.2022 dhe ndryshuar me Vkb nr.84 datë 30.11.2023, në shprehjen e ligjshmërisë nga Institucioni Prefektit Qarkut me nr.863/1 prot. datë 06.01.2025, me ndryshimet përkatëse sipas sugjerimeve të ardhura me shkresën nr.45/2 prot. datë 09.08.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë (Drejtoria Metodologjisë dhe Ligjore) Tiranë.

Komisioni vëren dhe konstaton se në projekt vendimin e paraqitur për shqyrtim, janë zbatuar me korrektesi sugjerimet e paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë (Drejtoria Metodologjisë dhe Ligjore) Tiranë me nr.45/2 datë 09.08.2024, kjo e kërkuar për zbatim edhe nga Institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër, shprehje ligjshmërie me nr.863/1 datë 06.01.2025.

Komisioni propozon miratimin e projekt vendimit në mbledhjen e muajit Janarë 2025.

Kryetar
Neki Kapllanaj

Zv/Kryetar
Arsen Mehmeti

Sekretarë
Florin Tanushi



Mbledhje e komisionit të financave, buxhetit, pasurive Bashkiake dhe planifikimit të zhvillimit strategjik të Bashkisë, mbikqyrjes financiare.

Data 24.01.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 1 datë 20/01/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për miratim shtesë plani në Buxhetin E Bashkisë Vau Dejës të miratuar me Vkb-Në Nr.84, datë 23.12.2024 "Për Miratimin E Buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm perfundimtar 2025-2027, numrin e punjonjësve të Bashkisë Vau Dejës".

Analiza ligjore: Në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja "d", nenit 54 shkronja "dh", të ligjit nr. 139 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligji nr 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; neni 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 "Për Financat E vetëqeverisjes vendore"; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; pika 190 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, VKB-në Nr.84, datë 23.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025-2027, numrin e punjonjësve të Bashkisë Vau Dejës", Shkresës Nr. 5245/24Prot, datë 30.12.2024 me lëndë "Njoftim", nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës.

Situata aktuale e funksionit: Në kuadër të Planit Social Vendor 2021-2023, miratuar me VKB-në Nr. 84, datë 24.12.2020, Bashkia ka aplikuar me kërkesë për financim të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor me projektin "Shërbim Lëvizës në Familje për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar në Bashkinë Vau Dejës", në thirrjen e hapur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në programin e Fondit Social 2024 dhe kërkesa është aprovuar. Projekti "Shërbim Lëvizës në Familje" ka pasur një nisje të suksesshme gjatë vitit të parë të zbatimit, duke ofruar shërbime në familje për familjet me aftësi të kufizuar që kanë nevojë për mbështetje dhe trajtim në kushte të përshtatshme dhe të sigurta për ta. Ky projekt ofrohet nga një ekip i përbërë nga katër profesionistë të kualifikuar: logopedi, punonjësi social, fizioterapisti dhe psikologu. Secili prej këtyre profesionistëve ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve dhe familjeve që kanë marrë shërbimin. Në vitin e parë të zbatimit, kemi arritur të implementojmë një sërë aktiviteteve dhe ndërhyrjesh që kanë pasur një ndikim pozitiv në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe familjeve, duke ofruar mbështetje në fushat e zhvillimit të aftësive të komunikimit, shëndetit mendor, rehabilitimit fizik dhe ndihmës sociale. Ky sukses i projektit është reflektuar në vlerësimet pozitive të pranuar nga familjet dhe partnerët e projektit, të cilët kanë theksuar rëndësinë e shërbimeve të ofruara dhe ndikimin e drejtpërdrejtë në jetën e tyre. Tani,



në vitin e dytë të implementimit të projektit, synojmë të vazhdojmë këtë projekt me thellimin e shërbimeve që ofrohen, duke ofruar mbështetje edhe më të specializuar për nevojat e ndryshme që mund të shfaqen gjatë kohës për fëmijët. Ekipi i Njësisë Lëvizëse do të vazhdojë të punojë ngushtë me çdo familje për të siguruar që çdo fëmijë pjesë e këtij projekti të marrë shërbimin që i nevojitet për zhvillimin dhe mirëqenien e tij.

Situata financiare : Ky projekt ka një kohëzgjatje prej 36 muajsh, dhe nëpërmjet shkresës Nr. 5245/24, datë 30.12.2024, jemi njoftuar për kalimin e fondit për vitin 2025 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në vlerën totale 2,999,664 (Dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, me TVSH. Nga vlera totale e financimit për vitin 2025, e cila është 5,083,948 (Pesë milion e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) lekë, kontributi i Fondit Social nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është 2,999,664 (Dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë lekë, me TVSH. Po ashtu, kontributi i Bashkisë për vitin 2025 është 2,084,284 (Dy milion e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) lekë, me TVSH.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria E Mbrojtjes, Përfshirjes Dhe Strehimit Social dhe Drejtoria e Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar kane relatuar për projekt vendimin

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjese.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 24/01/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.1 datë 20/01/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt Vendim ""Për miratim shtesë plani në Buxhetin E Bashkisë Vau Dejës të miratuar me Vkb-Në Nr.84, datë 23.12.2024 "Për Miratimin E Buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm perfundimtar 2025-2027, numrin e punjonjësve të Bashkise Vau Dejës" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,



VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Kryetar

Neki Kapllanaj

Zv/Kryetar

Arsen Mehmeti

Sekretarë

Florin Tanushi



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Mbledhje e komisionit Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.

Data 24.01.2025

RELACION

Komisioni u mbledh në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Njesia Administrative Bushat dhe shqyrtoi projekt vendimet e mëposhtëm:

-Projekt vendim për rishqyrtim i Vkb nr.95/2024 mbi “Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Gezim Osman Mahmutaj i dëmtuar nga zjarri me datë 26.10.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës”.

-Projekt vendim për rishqyrtim i Vkb nr.96/2024 mbi “Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Arben Ceko Et’hem i dëmtuar nga zjarri me datë 05.11.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës”

-Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetases Mandalina Mark Dragusha e dëmtuar nga zjarri me datë 13.12.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës.

Komisioni konstaton se projekt vendimet mbi “Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Gezim Osman Mahmutaj dhe shtetasit Arben Ceko Et’hem, janë plotësuar konform kërkesave të pasqyruera në shprehjet ligjore të Institucionit të Prefektit Qarkut Shkodër me nr.871/1 prot. dhe nr.872/1 prot. datë 06.01.2025.

Gjithashtu komisioni shqyrtoi edhe projekt vendimin për dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetases Mandalina Mark Dragusha e dëmtuar nga zjarri me datë 13.12.2024 nga ku konstatohet se projekt vendimi është hartuar konform legjislacionit në fuqi.

Komisioni shpreh dakortësi që projekt vendimet e mësipërme të miratohen në mbledhjen e muajit Janarë 2025.

Kryetarë
Mark Bisha

Zv/Kryetarë
Roberto Trushi

Sekretarë
Majlinda Ndreca



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Mbledhje e komisionit Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.

Data 24.01.2025

RELACION

Komisioni u mbledh në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Njesia Administrative Bushat dhe shqyrtoi projekt vendimet e mëposhtëm:

-Projekt vendim për rishqyrtim i Vkb nr.95/2024 mbi “Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Gezim Osman Mahmutaj i dëmtuar nga zjarri me datë 26.10.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës”.

-Projekt vendim për rishqyrtim i Vkb nr.96/2024 mbi “Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Arben Ceko Et’hemi i dëmtuar nga zjarri me datë 05.11.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës”

-Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasës Mandalina Mark Dragusha e dëmtuar nga zjarri me datë 13.12.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës.

Komisioni konstaton se projekt vendimet mbi “Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Gezim Osman Mahmutaj dhe shtetasit Arben Ceko Et’hemi, janë plotësuar konform kërkesave të pasqyruera në shprehjet ligjore të Institucionit të Prefektit Qarkut Shkodër me nr.871/1 prot. dhe nr.872/1 prot. datë 06.01.2025.

Gjithashtu komisioni shqyrtoi edhe projekt vendimin për dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasës Mandalina Mark Dragusha e dëmtuar nga zjarri me datë 13.12.2024 nga ku konstatohet se projekt vendimi është hartuar konform legjislacionit në fuqi.

Komisioni shpreh dakortësi që projekt vendimet e mësipërme të miratohen në mbledhjen e muajit Janarë 2025.

Kryetarë
Mark Bisha

Zv/Kryetarë
Roberto Trushi

Sekretarë
Majlinda Ndreca



Mbledhja e komisionit Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe biodiversitetit.

Data 24.01.2025

RELACION

Komisioni u mbledh në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Njesia Administrative Bushat dhe shqyrtoi projekt vendimin e mëposhtëm:

Projekt vendim për miratimin e listës së ngastrave /nëngastrave të gatshme për dhënie në përdorim për vitin 2025.

Komisioni diskutoi projekt vendimin e paraqitur nga sektori i administrimit të pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë Vau Dejes.

Bashkia Vau Dejes në administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore sipas mënyrës së përcaktuar me ligj në lidhje me sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave të kaluara në administrim e saj gjithsej 31.118.2 ha propozon dhenien e pëlqimit në parim për fondin Pyjore në sipërfaqe prej 14.247.91 ha, sipas listës së ngastrave bashkëngjitur projekt vendimit.

Pjesë jopyjore të fondit pyjor bashkiak, mund të jepen në përdorim për veprimtari biznesi dhe për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, gjeologjike e minerare, për gurore e kariera, pa cenuar vlerat dhe funksionet e tyre. Bashkia e ka të parashikuar edhe si objektiv në PPV zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullosore që sigurojnë shtimin e sipërfaqeve pyjore rrisin prodhimtarinë dhe aftësinë ripërtëritëse të pyjeve, parandalojnë degradimin e mëtejshëm të tokës, mbrojnë biodiversitetin e sigurojnë potencial maksimal për të përmbushur funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global pa cenuar ekosisteme të tjera. Në zbatim të VKM nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore", përcaktohen edhe tarifatat për ha të dhënies në përdorim si edhe afati i dhënies në përdorim nga 1 deri në 10 vite.

Komisioni vlereson se është zbatuar me korrektesë baza ligjore për hartimin e projekt vendimit dhe propozon që ky projekt vendim të miratohet në mbledhjen e muajit Janar 2025.

Kryetar
Kastriot Shkja

Zv/Kryetare
Mirela Vasija

Sekretar
Aleko Dodani



Mbledhja e komisionit Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe biodiversitetit.

Data 24.01.2025

RELACION

Komisioni u mbledh në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Njesia Administrative Bushat dhe shqyrtoi projekt vendimin e mëposhtëm:

“Projekt vendim për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje Bari dhe e pyjeve që kulloten për vitin 2025”

Komisioni u mbledh në sallën e mbledhjeve të Njesise Administrative Bushat, dhe shqyrtoi projekt vendimin e paraqitur nga Drejtoria e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit. Komisioni shpreh mendimin se miratimi i listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari të paraqitura në projekt vendim, sjell një përmirësim të nivelit të të ardhurave të Bashkisë për vitin 2025, në mënyrë të tillë që këshilli bashkiak të ketë mundësi ligjore për të dhënë në përdorim apo me qera kullotat që disponon në pronësi, prandaj komisioni shpreh dakortësi për miratim të projekt vendimit në mbledhjen e radhës së muajit Janar 2025.

Kryetar
Kastriot Shkja

Zv/Kryetare
Mirela Vasija

Sekretar
Aleko Dodani